



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Datë 30.09.2019

FTESË PUBLIKE PËR PROPOZIME ME BASHKËFINANCIM PËR TË GJITHA ORGANIZATAT JO-QEVERITARE

Komuna e Mamushës përkatësisht Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, bënë thirrje publike për aplikim të gjitha OJQ-të programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e shëndetësisë të aplikojnë për mbështetje financiare me bashkëfinancim për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, edukimit shëndetësor dhe kujdesit shtëpiak.

Kërkesa duhet të përmban:

- Qëllimin e kërkesës/projektit-propozimit
- Përshkrimin e aktiviteteve të projektit-propozimit plan programit për periudhën një vjeçare
- Kosto që kërkohet nga komuna
- Vlera e bashkëfinancimit nga OJQ, e cila duhet të jetë së paku 20% e vlerës totale të projekt-propozimit.

Kriteret e përgjithshme për aplikuesit:

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare me bashkëfinancim, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar dhe aktive sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;

- Të posedojë licencë valide nga Ministria e Shëndetësisë për shërbime mjekësore të mjekësisë interne, laboratorit të analizave, pediatriisë, gjinekologjisë dhe stafin specialist të këtyre fushave;
- Të dëshmojë se posedon pajisje mjekësore si ultrazë, EKG, aparaturë laboratorike;
- Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikanti duhet të jetë së paku 20% e vlerës totale të projekt-propozimit.

OJQ-të, mund të aplikojnë vetëm me një projekt. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë një vjeçare.

Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në kopje fizike në zyrat e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Afati për dorëzimin e propozimeve është 5 ditë pune, nga data. 01.10.2019 dhe përfundon më datën 15.10.2019 në ora 16:00.

Vetëm projektet që janë dorëzuar brenda afatit dhe janë në përputhshmëri me kriteret për aplikim të cekura më lartë do të procedohen për shqyrtim nga komisioni i përzgjedhur.

Drejtör i DSHMS

Rujdi MAZREK

